



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 203, Datë 04.12.2020

“MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E
OPERIMIT NË IMPIANTET E GNL-SË”.**

Në mbështetje të nenit 16, pika 11, nenit 22, nenit 23 të Ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" i ndryshuar, si dhe nenit 26 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 127/2 prot, datë 02.12.2020, të Drejtorive Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e licencës për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së,

Konstatohet se:

- ERE ka hartuar draft-licencën dhe kushtet e saj për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së, duke përcaktuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimit e të licencuarit mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.
- Draft-licenca me kushtet e saj për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së, saktëson spektrin e të drejtave dhe detyrimeve për çdo subjekt që licencohet në ushtrimin e këtij aktiviteti.
- Draft licenca saktëson tërësinë e të drejtave të ERE në raport me të licencuarin, në mbështetje të ligjit nr.102/2010 "Për sektorin e gazit Natyror" si dhe legjislacionit të miratuar në zbatim të tij.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e Licencës për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së.
2. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI